

shill.
M. Adet Rrg.
M. Adet Rrg.
M. Adet Rrg.



KUVENDI
NR 944 DATE 02.03.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2026

Lënda : Depozitim projektvendimi.

Drejtuar : Z. Niko PELESHI
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

I nderuar z.Kryetar,

Bazuar në nenin 75, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 117, të Rregullores së Kuvendit, bashkëlidhur kësaj shkrese paraqesim Projektvendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, së bashku me relacionin shoqërues.

Duke ju falënderuar,

DEPUTETËT PROPOZUES

1. **Taulant Balla**
2. **ERION MALAJ**
3. **Erjon Lila**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. /2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË
16.12.2004, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 117, të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, "Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas nenit a/7, shtohet neni a/8 me përmbajtje si më poshtë:

"Neni a/8

Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve që synojnë përafrimin

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përfshin menjëherë në programin dhe kalendarin e tij të punimeve dhe shqyrton me procedurë të përshpejtuar, projektligjet që synojnë përafrimin e

legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit, me përjashtim të ligjeve të parashikuara në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës”.

Neni 2

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Kuvendi miraton në seancë plenare ngritjen e 11 komisioneve të përhershme me emërtesat dhe fushat e përgjegjësisë si më poshtë:

- Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat.

(Çështjet e politikave ekonomike me përqasjen ndaj tregut të përbashkët evropian, Buxhetin e Shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, marrëdhëniet e punësimin, lirisë së lëvizjes së punëtorëve, financat publike, privatizimet dhe sistemin bankar.)

- Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike.

(Kodet dhe ligjet duke garantuar përputhshmërinë dhe zbatueshmërinë e tyre me standardin Europian; organizimin e pushtetit gjyqësor dhe raportimin e tij, administratën e pushtetit gjyqësor; administratën publike, institucionet e pavarura në sistemin e drejtësisë.)

- Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes.

(Çështjet e brendshme, të rendit, organizimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare e publike, organizimin e Forcave të Armatosura dhe bashkëpunimin ushtarak; çështjet e organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, emergjencat civile dhe mbrojtja nga fatkeqësitë, shërbimet sekrete.)

- Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet.

(Çështjet në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, inovacionit dhe politikave të zhvillimit të sportit.)

- Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale.

(Çështjet lidhur me politikave shëndetësore, sigurimet shoqërore, familjen, gruan dhe çështjet për mirëqenien sociale.)

-Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.

(Çështjet në fushën e energjisë, burimeve natyrore dhe biodiversitetit, infrastrukturën, industrinë dhe telekomunikacionin, rregullimin e territorit, tregtinë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet për zhvillimin e qëndrueshëm.)

- Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.

(Çështjet në fushën e të drejtave dhe liriye themelore të njeriut, çështjet lidhur me veprimtarinë e mediave audiovizive dhe informimit dhe çështjet për garantimin e lirisë së shprehjes.)

- Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural.

(Çështjet e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, çështjet e zhvillimit rural, çështjet e kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore, monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore.)

- Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën.

(Çështjet e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë kulturore; zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm; politikat për ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor të diasporës dhe të pjesëmarrjes së saj në proceset politike dhe sociale në vend.)

- Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme.

(Çështjet e integrimit evropian, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian; mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë; monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, politikat e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.)

- Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

(Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të strategjive, rezolutave, vendimeve dhe planeve të veprimit të Kuvendit; shqyrtimi dhe ndjekja e nismave të qytetarëve dhe peticioneve; realizimi dhe koordinimi, mbikëqyrja dhe kontrolli i zbatimit të ligjeve nga ekzekutivi, institucionet dhe agjencitë e pavarura prej tij, përmes koordinimit të procesit parlamentar për kontrollin postlegjislativ (PLS); koordinimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërinstytucional.)

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 përmbajtje si më poshtë:

“4. Kudo në Rregulloren e Kuvendit emërtesat e komisioneve të përhershme zëvendësohen sipas emërtesës së komisioneve të përhershme në nenin 19, pika 1, të këtij vendimi.”.

Neni 3

Në nenin 20 pika 3 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 28 pika 2, fjalia e fundit “Projektligji që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian nuk shqyrtohet me procedurë të përsheptuar” shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 47 pika 1/1, togfjalëshi “jo më shumë se 10 minuta”, zëvendësohet me togfjalëshin “jo më shumë se 5 minuta”.

Neni 6

Në nenin 48, pika 1, fjalët “jo më shumë se 10 minuta” zëvendësohen me fjalët “jo më shumë se 5 minuta”.

Neni 7

Në nenin 102, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 4, ndryshon si më poshtë:

“4. Komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale, në kuadër të funksionit të kontrollit parlamentar ndaj ministrive dhe institucioneve të tjera publike, koordinon dhe ndjek realizimin e procesit të Kontrollit Post-Legjislativ të ligjeve të miratuara nga Kuvendi për sa i takon zbatimin dhe efektivitetin të tyre duke bashkëpunuar edhe me komisionet e tjera të përhershme parlamentare brenda fushave përkatëse të tyre të përgjegjësisë.”

2. Pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si më poshtë:

“5. Në kuadër të këtij procesi komisionet organizojnë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara.”

Neni 8

Neni 103 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 103

Raportimi në Kuvend

1. Konferenca e Kryetarëve, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, vendos në fillim të çdo viti për kalendarin e paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

2. Kalendarin përmban organin kushtetues dhe atë të krijuar me ligj që do të raportojë, komisionet përgjegjëse për shqyrtim dhe afatin ligjor për depozitimin e raportit në Kuvend. Kuvendi u kërkon zyrtarisht institucioneve të mësipërme dorëzimin e raportit në Kuvend brenda afatit ligjor. Në rastet kur afati ligjor për depozitimin e raportit nuk është i përcaktuar në ligjin organik të institucionit, Konferenca vendos afatin e depozitimit të tij.

Kalendarin i paraqitjes së raporteve njoftohet në seancën plenare më të parë, publikohet dhe iu shpërndahet institucioneve.

Në rast se nuk arrihet mirëkuptimi për kalendarin në konferencën e kryetarëve zbatohen përcaktimet e pikës 4, të nenit 27 të rregullores.

3. Raporti i institucioneve, pas paraqitjes, futet menjëherë në programin e punës së Kuvendit dhe shqyrtohet nga komisioni përgjegjës i fushës.
4. Komisioni përgjegjës i fushës organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe në përfundim të diskutimeve harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, ose përfshin rekomandime specifike në raportin e komisionit të cilat ja përcjell komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale.
5. Komisioni për mbikëqyrjen institucionale organizon seancën dëgjimore në të cilën drejtuesi i institucionit raporton për zbatimin e rezolutës së Kuvendit për vitin paraardhës dhe vlerësimin rreth projektrezolutës/rekomandimeve të paraqitura nga komisioni përgjegjës i fushës për vitin në vazhdim.
6. Projektrezoluta e miratuar në mbledhjen e komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale i paraqitet seancës plenare, ndërsa raporti me rekomandime specifike, i përcillet me shkresë institucionit të pavarur përkatës.
7. Komisionet, kur e çmojnë të nevojshme, në varësi të çështjeve të trajtuara në raportin vjetor ose që dalin gjatë shqyrtimit të tij, mund t'u kërkojnë informacione me shkrim institucioneve të tjera shtetërore ose institucioneve të pavarura, si dhe/ose t'i ftojnë në seancë dëgjimore organizatat e shoqërisë civile, që bashkëveprojnë dhe kontribuojnë në fushat që mbulon institucioni i pavarur.
8. Në projektrezolutë komisionet mund të reflektojnë rekomandime bazuar edhe në faktet e mbledhura nga organet e përmendura në pikën 7 të këtij neni.
9. Në seancë plenare lexohet projektrezoluta për vlerësimin e punës së institucionit dhe më pas vijohet me diskutimet në lidhje me të.
10. Një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë kanë të drejtë të kërkojnë me shkrim zhvillimin e debatit. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve dhe çdo deputet ka të drejtë të flasë jo më shumë se 5 minuta.
11. Mekanizmi i Monitorimit Periodik dhe Vjetor të Institucioneve, miratohet në seancë plenare. Komisioni përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale ndjek në vijimësi zbatimin e tij dhe kur çmohet e nevojshme informon Kuvendin për problematikat e dala.”

Neni 9

Në nenin 103/1 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 6, ndryshohet si më poshtë:

“6. Komisionet e përhershme parlamentare sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, mund të thërrasin institucionet kushtetuese të pavarura dhe institucionet e krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin, për të raportuar dhe për të dhënë informacione për çështje të integritetit evropian, duke u koordinuar paraprakisht me Komisionin për Çështjet Evropiane.”

2. Në fund të pikës 7, shtohet fjalja me këtë përmbajtje:

“Para miratimit kalendari koordinohet me Komisionin përgjegjës për Çështjet Evropiane.”

Neni 10

Në nenin 103/3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Pas miratimit të planit nga Konferenca e Kryetarëve, Kryetari i Kuvendit ia përcjell planin vjetor me afatet kohore të përcaktuara ministrit përgjegjës për Marrëdhëniet me Kuvendin dhe ministrive përgjegjëse.”

2. Në fjalinë e parë të pikës 4, togfjalëshi “ Komisionit për Evropën dhe Punët e Jashtme” ndryshohet me fjalën “ Komisioneve”.

Neni 11

Në nenin 103/4 shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

“4. Komisioni përgjegjës për Nismat qytetare, bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen institucionale koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e Strategjive dhe Planeve të Veprimit të miratuara nga Kuvendi. Në mbyllje të çdo sesioni ai i paraqet Konferencës së Kryetarëve një raport informues mbi këtë proces. Kryetari i Kuvendit nëse e çmon të arsyeshme vendos paraqitjen e tij në seancë plenare.”

Neni 12

Neni 104 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 104

Nismat qytetare dhe petitionet

1. Nismat qytetare dhe petitionet, të cilat i drejtohen Kuvendit, shqyrtohen nga Komisioni përgjegjës për Nismat Qytetare, bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen institucionale.
2. Pranohen për shqyrtim nismat dhe petitionet, të cilat janë bërë me shkrim, kanë emrin e dërguesit dhe nënshkrimet përkatëse, janë të kuptueshme dhe tregojnë qartë objektin e tyre.
3. Kërkesat me nisma qytetare dhe petitionet dërgohen nga Kryetari i Kuvendit në Komisionin përgjegjës për Nismat qytetare dhe petitionet. Kryetari i komisionit mund t’ia kthejë nismën ose petitionin dërguesve për rihartim ose t’u kërkojë atyre sqarime shtesë.
4. Jo më vonë se 45 ditë nga data e marrjes së petitionit, Kryetari i komisionit e paraqet kërkesën me nismën ose petitionin në komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes ligjore ose mospranimin e tyre. Në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen

e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit, për të paraqitur një deklaratë në seancën plenare të Kuvendit. Hapat e ndërmarrë dhe zgjidhja e çështjes së ngritur i njoftohen dërguesve të nismës ose peticionit.

5. Komisioni përgjegjës mund të vendosë dërgimin e nismës ose peticionit një komisioni tjetër parlamentar që ka lidhje me objektin e paraqitur në peticion, Këshillit të Ministrave, institucioneve publike dhe Institucioneve të pavarura përgjegjëse për fushën për veprime të mëtejshme, me qëllim marrjen e informacioneve. Në përfundim, komisioni jep shpjegime me shkrim, propozon nismë legjislativë ose merr vendim.

6. Kuvendi miraton Mekanizmin e trajtimit dhe shqyrtimit të nismave qytetare dhe peticioneve”.

Neni 13

Në nenin 110, pika 4, fjalia e dytë, fjalët “në përputhje me nenin 48 të kësaj Rregulloreje”, zëvendësohen me fjalët “në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve, sipas përfaqësimit të tyre në Kuvend, por në çdo rast jo më shumë se 10 minuta për çdo deputet.”

Neni 14

Neni 111 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 111

Zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj me propozim të institucioneve të tjera.

1. Për kandidaturat në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me propozim të institucioneve të tjera, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj, zhvillohet procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

- a) Sekretari i Përgjithshëm tre muaj përpara përfundimit të mandatit ose menjëherë në rastet e shkarkimit të anëtarit të organit kushtetues ose të krijuar me ligj njofton me shkrim institucionin propozues, i cili fillon praktikën për zgjedhjen e anëtarit të ri.
- b) Kandidaturat duhet të paraqiten në Kuvend 45 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit dhe jo më vonë se 10 ditë pas shkarkimit të tij.
- c) Me paraqitjen e kandidaturave, Kryetari i Kuvendit ia kalon ato menjëherë komisionit përgjegjës, i cili brenda tre javëve nga marrja e kërkesës organizon seanca dëgjimore publike me secilin kandidat dhe vendos nëse kandidaturat i plotësojnë kriteret kushtetuese, ligjore dhe meritën.
- ç) Në rastin kur ka mangësi në dokumentacion për kandidaturën, komisioni i kërkon zyrtarisht institucionit propozues për plotësimin e tij. Në rastin kur kandidatura nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, komisioni i kërkon Kryetarit të Kuvendit të njoftojë

institucionin propozues. Procedura e shqyrtimit në Kuvend vazhdon me paraqitjen e kandidaturës së re nga institucioni propozues.

2. Kuvendi shqyrton propozimin dhe kryen votimin për kandidatët në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës.

3. Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, Kuvendi njofton institucionin propozues. Procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.

Neni 15

Pas nenit 111, shtohet neni 111/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 111/1

Zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj me propozim të një grupi deputetësh.

1. Për kandidaturat në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me propozim të një grupi deputetësh, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj, zhvillohet procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

a) Komisioni përgjegjës, tre muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit kushtetues ose të krijuar me ligj vendos shpalljen dhe publikimin e vakancës në faqen zyrtare të Kuvendit. Afati për paraqitjen e kandidaturave është 20 ditë nga publikimi i vendimit.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, komisioni përgjegjës u bën të njohur anëtarëve të Kuvendit listën me kandidaturat e vetëofruara si dhe brenda 5 ditëve nga dërgimi i listës, organizon dëgjuesën e hapur publike në mjediset e Kuvendit, ku njoftohen të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Lista me kandidatët e vetëofruar bëhet publike në faqen zyrtare të Kuvendit.

c) Brenda tre javëve nga dëgjesa publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin, që do të mbështesin për t'ia propozuar Kuvendit, sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit.

ç) Mbështetja me nënshkrimet e të paktën 28 deputetëve depozitohet zyrtarisht në protokollin e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ia kalon ato menjëherë komisionit përgjegjës, i cili brenda tre javëve nga marrja e kërkesës vendos nëse kandidaturat i plotësojnë kriteret kushtetuese, ligjore dhe meritën.

2. Kuvendi shqyrton propozimin dhe kryen votimin për kandidatët në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës.

3. Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, Kuvendi rishpall vakancën, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.

Neni 16

Në nenin 115 pika 1, ndryshohet si më poshtë:

“1. Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në ligj, nga jo më pak se 28 deputetë, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Niko PELESHI

Miratuar në datën _____, 2026

**RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166,
DATË 16.12.2004, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT

Ky projektvendim ka për qëllim përmirësimin e disa dispozitave të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me synim forcimin e rolit kushtetues të Kuvendit në procesin ligjvënës, ushtrimin e kontrollit parlamentar dhe mbikëqyrjen institucionale, si dhe rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes qytetare.

Në mënyrë të veçantë, projektvendimi parashikon ndryshimin e nenit 19 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke rritur numrin e komisioneve të përhershme parlamentare nga tetë në njëmbëdhjetë. Ky riorganizim synon rritjen e efektivitetit të Kuvendit si organi më i lartë përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës, si dhe përafrimin e strukturës së tij me kërkesat që burojnë nga procesi i integritit evropian dhe përafrimi i legjislacionit vendas me acquis të Bashkimit Evropian.

II. OBJEKTI I PROJEKTVENDIMIT

Ky projektvendim synon ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim:

institucioneve, agjencive etj të zbatojmë të njëjtat mekanizma dhe procedura si në praktikat dhe eksperiencat më të mira në vendet e BE.

Në vijim të Njoftimit Publik, datë 23 Shkurt 2026, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë ku njoftohet se “Gjykata vlerësoi se duhet vendosur shfuqizimi i vendimit të Kuvendit (57/2025) për shkak të cënimit të parimit të demokracisë përfaqësuese të lidhur me lirinë e shprehjes së deputetëve si pasojë e shkeljes së rregullave të thirrjes së mbledhjes së Kuvendit si dhe të procedurës së ndjekur për miratimin e aktit objekt shqyrtimi...Gjykata vendosi që efektet e këtij shfuqizimi hyjnë në fuqi 30 ditë pas botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare, në mënyrë që gjatë këtij afati, Kuvendi të ketë mundësinë e organizimit të komisioneve parlamentare sipas standardeve për procedurën e miratimit të akteve të përcaktuar në arsyetimin e këtij vendimi”.

Bazuar sa më sipër propozojmë futjen sërish të ndryshimeve të Rregullores së Kuvendit në Nenin 19 “Komisionet e përhershme dhe nënkomisionet e Kuvendit”. Besojmë se mjaftuan këto 5 muaj për të na dhënë të drejtë në nevojën e kësaj ndarje të re, por mbi të gjitha për komisionet e reja të ngritura, si rrjedhojë e kësaj faze sfiduese të Shqipërisë në prag të anëtarësimit në Bashkimin European.

Komisionet që erdhën me fusha të reja mbulimi i kanë dhënë mundësinë e munguar ndër vite Kuvendit të jetë më efektiv në monitorimin post-legislation. Është mbresëlënëse numri i konsiderueshëm i peticioneve/ankesave të qytetarëve të mbërritura në komisionin e përhershëm përkatës. Ndërsa ngritja e Komisionit për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën na imponon një marrëdhënie më të fortë për të qenë syri dhe veshi i shqiptarëve në cdo cep të globit. Por kjo nuk duhet të mbesë thjeshtë tek emri i komisionit. Transformimi i strukturës së tete komisioneve ekzistuese në një sistem prej 11 komisionesh të specializuara, përfaqëson një përgjigje të nevojshme për të rritur kapacitetet parlamentare në fushat kyçe të negociatave.

- Shtesës së procedurës së përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjeve që lidhen me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.
- Emërtesat dhe ndarjen e përgjegjësi të komisioneve të përhershme parlamentare.
- Ndryshimeve në procedurat e raportimit dhe mbikëqyrjes institucionale, me qëllim një proces më të plotë në komisionet e Kuvendit dhe në debati efikas në seancë plenare.
- Rregullimeve në kohëzgjatjen e fjalimeve të deputetëve dhe të anëtarëve të Këshillit të Ministrave.
- Përmirësimin e procesit të mbikëqyrjes institucionale, harmonizimin dhe rregullimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të organeve kushtetuese ose të krijuara me ligj.

III. PËRPARËSITË E PROJEKTVENDIMIT DHE EFEKTET E PRITSHME

Në Dhjetor 2025, Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të RSH në BE”, ku thelbi i ndryshimeve ishte parashikimi i procedurës së përshpejtuar për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve që synojnë përafrimin e legjislacionit dhe përmbushjen e kriterëve/detyrimeve të anëtarësimit. Gjatë më pak se 6 muajve të parë të kësaj legjislature janë shqyrtuar dhe miratuar një numër i shtuar ligjesh me objekt përafrimin e legjislacionit tonë kombëtar me acquis të Bashkimit Europian. Në çdo rast këto procedura duhet të garantojnë hapësirat e konsultimit, njohje dhe pjesëmarrje efikase të deputetëve në debatin e parashikuar në komisione dhe në seancë, ndërsa janë në proces një numër edhe i madh projekt-ligjesh. Ndryshimet në Ligjin “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të RSH në BE” na detyrojnë të ndërmarrim edhe këto ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, Gjithashtu janë propozuar edhe ndryshime të tjera të cilat synojnë të përmirësojmë aktivitetin dhe debatin parlamentar dhe të rrisim efektivitetin e kontrollit parlamentar. Jemi në momentin e duhur që në procesin e raportimit në Kuvend të

Kemi Përshpejtim të procedurave për projektligjet që lidhen me integrimin evropian, procedurë e cila lejon reagim të shpejtë ndaj angazhimeve ndërkombëtare, duke rritur fleksibilitetin parlament

Rritja e efikasitetit të seancave dhe fjalimeve ku koha maksimale e fjalimeve të deputetëve dhe komisioneve reduktohet nga 10 minuta në 5 minuta, gjë e cila rrit dinamizmin e seancave dhe mundëson përfshirjen e më shumë folësve.

Gjithashtu kemi përmirësimin e procesit të mbikëqyrjes institucionale, harmonizimin dhe rregullimin e procedurave për zgjedhjen e anëtarëve të organeve kushtetuese ose të krijuara me ligj.

IV. PËRMBLEDHJE E NDRYSHIMEVE KRYESORE

1. Me shtimin e nenit a/8 parashikohet përfshirja e menjëhershme në programin dhe kalendarin e

punimeve të Kuvendit e projektligjeve që synojnë përafrimin e legjislacionit dhe shqyrtimi i tyre me procedurë të përshpejtuar, në përputhje dhe me ndryshimet ligjore të miratuara së fundmi në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. Ky ndryshim kërkon në vijim dhe shfuqizimin e fjalisë së dytë të pikës 2, të nenit 28, me synim rritjen e efikasitetit të procesit ligjvënës dhe përmbushjen në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian.

2. Ndryshimi i neneve 19 dhe 20 të Rregullores së Kuvendit parashikon, ngritjen e 11 komisioneve të përhershme parlamentare me prioritet të veprimtarisë këto fusha përgjegjësie:

1. Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat do të ketë fushë përgjegjësie çështjet e politikave ekonomike me përfaqshjen ndaj tregut të përbashkët Evropian, Buxhetin e Shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, marrëdhëniet e punësimit, lirisë së lëvizjes së punëtorëve, financat publike, privatizimet dhe sistemi bankar.

2. Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike do të ketë fushë përgjegjësie Kodet dhe ligjet duke garantuar përputhshmërinë dhe zbatueshmërinë e tyre me standardin Europian, organizimin e pushtetit gjyqësor dhe raportimin e tij, administratën e pushtetit gjyqësor, administratën publike, shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë.

3. Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe Mbrojtjen do të ketë fushë përgjegjësie me fokus çështjet e brendshme, të rendit, organizimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare e publike, organizimin e forcave të armatosura dhe bashkëpunimin ushtarak, çështjet e organizimit dhe funksionimit të, pushtetit vendor, emergjencat civile dhe mbrojtja nga fatkeqësitë, shërbimet sekrete.

4. Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet do të ketë fushë përgjegjësie arsimin, kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin e sportit.

5. Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale do të ketë fushë përgjegjësie çështjet lidhur me politikat shëndetësore, sigurimet shoqërore, familjen, gruan dhe çështjet mbi mirëqenien sociale.

6. Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm do të ketë fushë përgjegjësie çështjet në fushën e energjisë, burimeve natyrore dhe biodiversitetit, infrastrukturën, industrinë dhe telekomunikacionin, rregullimin e territorit, tregtinë dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe çështjet për zhvillimin e qëndrueshëm.

7. Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik do të ketë fushë përgjegjësie çështje në fushën e të drejtave dhe liritë themelore të njeriut, çështjet lidhur me veprimtarinë e mediave audiovizive dhe informimit, çështjet për garantimin e lirisë së shprehjes.

8. Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural do të ketë fushë përgjegjësie çështjet e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, çështjet e zhvillimit rural, çështje të kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore, monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore

9. Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën do të ketë fushë përgjegjësie çështjet e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, politikat për ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor të diasporës dhe të pjesëmarrjes së saj në proceset politike dhe sociale në vend.

10. Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme do të ketë fushë përgjegjësie çështjet e integritit evropian, përafrimin e legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian. mbikëqyrjen e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit, si dhe mbikëqyrjen e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë. Gjithashtu monitorimin e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, politikat e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare

11. Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale do të ketë fushë përgjegjësie monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të strategjive, rezolutave, vendimeve dhe planeve të veprimit të Kuvendit. Shqyrtimin dhe ndjekjen e nismave të qytetarëve dhe peticioneve. Mbikëqyrja dhe kontrollin e zbatimit të ligjeve nga ekzekutivi, institucionet dhe agjencitë e pavarura prej tij, përmes koordinimit të procesit parlamentar për kontrollin post-legjislativ (PLS). Koordinimin e dialogut dhe bashkëpunimin ndërinstitutional.

3. Neni 3 propozon shfuqizimin e pikës 3 të nenit 20 pasi bazuar në ndryshimet e propozuara në nenin 2 është e panevojshme.

4. Ndryshimet në nenet 47 dhe 48 të rregullores kanë për qëllim të përmirësojnë efikasitetin e punës së kuvendit dhe të mundësojnë një debat më të strukturuar dhe me pjesëmarrje më të gjerë. Reduktimi i kohës së fjalës nga 10 në 5 minuta për ministrat dhe deputetët është një masë që mund të ndihmojë në shmangien e abuzimit të kohës dhe në mbajtjen e fokusit në çështjet kyçe. Kjo është një qasje që i përshtatet praktikave të Parlamenteve evropiane, ku koha e fjalës përcaktohet me qëllim që të sigurohet një diskutim i balancuar dhe në përputhje me rendin e ditës, dhe që mundëson një shqyrtim të shpejtë dhe efektiv të amendamenteve dhe votimin e projektligjeve.

5. Ndryshimet në nenin 102, forcojnë rolin e komisionit përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale në koordinimin e kontrollit post-legjislativ dhe parashikojnë organizimin e seancave dëgjimore publike me aktorë institucionalë dhe shoqërinë civile.

6. Riformulimi i nenit 103, krijon një kuadër më të qartë dhe të strukturuar për raportimin e institucioneve në Kuvend, duke përcaktuar rolin e Konferencës së Kryetarëve, komisioneve të përhershme dhe procedurat e miratimit të projektrezolutave ose rekomandimeve.

7. Ndryshimet në nenin 103/1 synojnë përmirësimin e koordinimit ndërmjet komisioneve parlamentare dhe Komisionit për Çështjet Evropiane në procesin e raportimit për integrimin evropian.

8. Ndryshimet në nenin 103/3 dhe shtesa në nenin 103/4 forcojnë mekanizmat e shqyrtimit ex-post të legjislacionit të përafruar me legjislacionin e BE-së dhe rolin e Kuvendit në ndjekjen e zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit.

9. Riformulimi i nenit 104 rregullon në mënyrë më të detajuar procedurat për nismat qytetare dhe peticionet, duke garantuar afate të qarta shqyrtimi dhe transparencë në komunikimin me dërguesit.

10. Ndryshimi në nenin 110 pika 4, synon harmonizimin e dispozitave rregullatore lidhur me kohën e diskutimeve, duke zëvendësuar referencën ndaj nenit 48 me një formulim të drejtpërdrejtë që garanton shpërndarjen proporcionale të kohës ndërmjet grupeve parlamentare dhe kufizimin maksimal prej 10 minutash për çdo deputet. Këto ndryshime sigurojnë zbatim më të njëtrajtshëm të rregullave gjatë shqyrtimit të çështjeve në seancë plenare, duke balancuar nevojën për debat gjithëpërfshirës me kërkesën për efikasitet procedural.

11. Ndryshimet në nenet 111 dhe shtimi i nenit 111/1 synojnë rritjen e transparencës dhe meritokracisë në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të organeve kushtetuese ose të krijuara me ligj, si dhe përcaktimin e qartë të afateve dhe procedurave përkatëse.

12. Ndryshimi i nenit 115 forcon kriteret procedurale për paraqitjen e kërkesave për shkarkimin e anëtarëve të organeve të krijuara me ligj.

V. PËRPUTHSHMËRIA ME KUSHTETUTËN DHE LEGJISLACIONIN NË FUQI

Projektvendimi është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në veçanti me parimet që rregullojnë funksionimin e Kuvendit, ushtrimin e funksionit ligjvënës dhe kontrollin parlamentar. Ndryshimet e propozuara nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, por synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator të brendshëm të Kuvendit.

VI. PËRPUTHSHMËRIA ME ACQUIS TË BE-SË

Ndryshimet e propozuara janë në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira parlamentare të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, veçanërisht në lidhje kontrollin post-legjislativ dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve të BE-së.

VII. KONKLUZIONE

Miratimi i këtij projektvendimi do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së veprimtarisë parlamentare, duke forcuar rolin e Kuvendit në procesin e integritit evropian dhe në mbikëqyrjen demokratike të institucioneve publike. Për këto arsye, propozohet miratimi i projektvendimit të bashkëlidhur.